Kronikë

Zjarrfikësi i Këlcyrës dhe miku i tij trafik armësh, do i shisnin në Sarandë për bandat, vihen në pranga! VIDEO e pistoletave të mbështjella me qese

Dy të rinj janë arrestuar në Sarandë ndërsa ishin gati që të trafikonin 10 armë. Ata janë kapur nga Policia në aksin Sarandë-Skërficë, ndërsa po udhëtonin drejt qytetit bregdetar aty ku do të takonin edhe personat që kishin porositur armët.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
13 Shtator, 16:35 | **Përditësimi: 13 Shtator, 18:12**

Share

SARANDË- Dy të rinj janë arrestuar në Sarandë ndërsa ishin gati që të trafikonin 10 armë. Ata janë kapur nga Policia në aksin Sarandë-Skërficë, ndërsa po udhëtonin drejt qytetit bregdetar aty ku do të takonin edhe personat që kishin porositur armët.

Në pranga kanë rënë drejtuesi i mjetit Mehmet Canaj, 24 vjeç, dhe pasagjeri Klaudio Osmani, 23 vjeç, të dy banues në Këlcyrë, Përmet. Osmani punonte edhe në stacionin zjarrfikës të Këlcyrës, ndërsa siç shihet edhe në pamje në momentin e arrestimit ai ka të veshur uniformën e punës.

Policia njofton se dy të rinjtë kishin si qëllim shitjen e armëve në Sarandë. Se kush ishte porositësi është ende mister, ndërsa blutë po vijojnë hetimet për të identifikuar persona të tjerë që mund të jenë të përfshirë.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
VIDEO/ Reshjet e dendura të shiut përmbytin rrugët e bizneset në Sarandë, qytetarët dhe pronarët bëjnë thirrje për ndërhyrje

Në videon e ndarë, dallohen edhe 10 armët "Glock" të cilat dy të rinjtë i kishin fshehur në një qese. Armët janë dërguar në Institutin e Policisë Shkencore për ekzaminime të mëtejshme, për të parë nëse janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.

> *"Strukturat e Hetimit në DVP Vlorë dhe Shërbimet e Komisariatit të Policisë Sarandë, në vijim të punës për garantimin e sundimit të ligjit në territor dhe për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e prodhimit, shitjes dhe trafikimit të armëve, si dhe për vënien përpara përgjegjësisë penale të shtetasve që i disponojnë ato, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Knock Out 7", në kuadër të të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: Mehmet Canaj, 24 vjeç, dhe Klaudio Osmani, 23 vjeç, të dy banues në Këlcyrë, Përmet.*
>
> *Pas lokalizimit dhe prangosjes së këtyre shtetasve në aksin rrugor "Sarandë-Skërficë", shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në automjetin me drejtues shtetasin Mehmet Canaj dhe pasagjer shtetasin Klaudio Osmani (i cili rezulton edhe i punësuar në stacionin zjarrfikës Këlcyrë), sekuestruan 10 armë zjarri pistolета tip "Glock" dhe 150 fishekë luftarak. Nga veprimet hetimore, dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, po i transportonin armët me qëllim shitjen e tyre në qytetin e Sarandës", njofton Policia.*

Policia ka sekuestruar edhe 150 fishekë luftarakë, si edhe mjetin tip "Nissan" me të cilin po të lëviznin dy të rinjtë. Ndaj tyre rëndojnë akuzat për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Trafikimi i armëve dhe i municionit", kryer në bashkëpunim.

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Mehmet Canaj | trafik armesh | sarande | Vlore | Klaudio Osmani

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
PS abstenon e s'e çon mandatin e Xhaçkës në Kushtetuese, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Kategoria e Parë/ Flamurtari shkëlqen me tre gola, mposht Vorën dhe merr vendin e dytë
13 Shtator, 09:14



Vlorë/ Vodhi 150 mijë lekë në një kazino dhe plagosi me thikë një 41-vjeçare, në pranga 25-vjeçari
13 Shtator, 08:58

VIDEOLAJM/Pamjet e pazakonta në plazhin e Jalës! Shikoni vorbullën e ajrit mbi det
12 Shtator, 17:35

KQZ i jep zyrtarisht mandatin, Vangjel Tavo kryebashkiaku i ri i Himarës! Pritet betimi, PBDNJ dhe Beleri e kontestojnë
12 Shtator, 08:37

I hapet rruga betimit të Vangjel Tavos, nesër KQZ i jep mandatin si kryebashkiak i Himarës
11 Shtator, 10:16

Zbulohen pamjet e aksionit të 9 gushtit/ Të maskuar dhe me snajper, momenti kur FAST mësyn hotelin tek 'Uji i Ftohtë' në Vlorë për 2 të kërkuarit nga SPAK (VIDEO)
10 Shtator, 12:42

SPAK kopsit dosjen për Jorgo Goron, ish kryebashkiakun e Himarës e akuzon për tjetërsim pronash e fshehje të pasurisë
10 Shtator, 12:29

Vlorë/ Sezoni i ri shkollor, AKU nis kontrollet në subjektet tregtare afër shkollave, Hyseni: Qëllim, garantimi i sigurisë ushqimore dhe fëmijëve
10 Shtator, 09:47



Kërcënoi fqinjin se do e vrasë, pranga 51-vjeçarit në Vlorë! I gjendet kallashnikovi në fuçinë e verës (VIDEO)
10 Shtator, 09:25

Zgjedhjet në Himarë/ Kolegji Zgjedhor rrëzon koalicionin 'Bashkë Fitojmë', i hapet rruga betimit të Vangjel Tavos si kryebashkiak
9 Shtator, 17:22

Himarë/ 2 turistë nga Maqedonia u bllokuan në Gjirin e Filikurit, shpëtohen nga policia
9 Shtator, 16:59

Vlorë/ Zjarr i fuqishëm pranë autostradës në Panaja, shkrumbohen bimësi dhe ullishta! Era favorizon flakët, të panjohura shkaqet (VIDEO)
9 Shtator, 14:21

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje